



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 53

Prishtinë, më 23.02.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Genc Jaha - KDI; Florina Merovci-ZPRK; Grese Sermahaj-KOSOVA SOT; Agon Gashi-PILPG; Rinor Kryeziu-PILPG; Kosovare Maliqi; RROKUM TV; Gentiana Kadrija-KOSOVA-PRESS; Gentiana Kryeziu-PRAKTIKANTE; Sanije Berisha-OSBE; Besmir Kokollari-ICHAT; Blerta Bejtullahu-EUSK/EULEX; Besa Maliqi-Norë Shabani KOHA DITORE dhe Norë Shabani -BIRN.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.1.2016;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-31 për Procedurën e përgjithshme Administrative;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare;

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja propozoi që në rend dite të hynë edhe: Procedimi i Projektligjit nr. 05/L-049 Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar, apo Konfiskuar dhe Projektligjit nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.01.2016

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 26.01.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-31 për Procedurën e përgjithshme Administrative

Kryesuesja e hap diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Milena Miličević- Paraqiti vërejtje sa i përket përkthimit në gjuhën serbe, ajo tha se komisioni për legjislacion po i kushton rëndësi këtyre lëshimeve sepse ka shumë fjalë që janë përdorur e nuk u dihet kuptimi. Këto paqartësi duhet të rregullohen.

Armend Zemaj –Në mandatin e kaluar ka pasur iniciative ligjore që kjo fushë të jetë më e rregulluar, e sidomos pjesa ku ka të bëjë me konfliktet administrative. Me pas ai shtoi se ky ligj, pavarësisht amendamenteve të propozuara, duhet shumë punë që kjo rregullativë ligjore të përmbushet. Ai potencoi se ky ligj ka shumë vërejtje dhe nuk duhet të kalojë sepse mund të jetë i pa zbatueshëm në praktikë, e sidomos do të jetë problem te ata persona të cilët janë palë në konflikt administrativ. Z. Zemaj nuk la pa përmendur si shembull të mirë komentarin për Procedurë Administrative ku thotë se aty mund të vërehen dallimet në nocione ose në qëllimin dhe përmbajtjen që janë komplet në kundërshtim njëra me tjetrën. Ai gjithashtu ritheksoi se në këtë formë ky ligj nuk do të jetë i zbatueshëm dhe si Komision Funkcional nuk mund ta kalojmë. Zemaj propozon që ky projektligj t'i kthehet komisionit dhe pastaj nëse komisioni vendos që ta përcjellë këtë ligj ne japim mendim që të mos miratohet në seancë plenare por, tha ai, mund të rekomandojmë nga sponsorizuesi që ta tërheq këtë ligj dhe në qoftë se nuk tërhiqet duhet të kthehet në komisionin për legjislacion dhe të punohet rreth këtij ligji, tha në fund Armend Zemaj.

Agim Aliu – Shprehet i habitur se si një ligj i tillë të mos jetë pjesë e komisionit për legjislacion duke ditur se shumë pjesë të përmbajtjes që do të duhej t'i kishte një projektligj i tillë do të duhej të ishin pjesë e fushëveprimit të komisionit tonë. Duke mos dashur të mohojmë punën që është bërë nga Komisioni Funkcional. Gjithashtu rekomandimet që janë dhënë nga stafi i Komisionit

për legjislacion ky projektligj nuk duhet të kalojë sepse i mungojnë elementet esenciale, mungon standardi i të bërit një projektligj, potencoi z. Aliu. Gjithashtu duke pasur parasysh këto elemente pra, qëllimi, përkufizimi, përmbajtja dhe sado të jetë i zbatueshëm z. Aliu propozon që duhet të diskutohet se si të kthehet ky projektligj dhe nëse është e mundur që dy komisionet të bëjnë një grup punues së bashku me sponsorizuesin dhe të shqyrtohet ky projektligj që të bëhen ndërhyrje ose në të kundërtën të kërkojmë nga Ministria që të tërhiqet dhe të përgatitet një projektligj që vërtet na duhet, tha në fund deputeti Agim Aliu.

Agim Ademaj- Në fjalën e tij tha se projektligji ka mjaft materie, por problemi kryesor qëndron te mos sistemimi si duhet i këtij projektligji. Z. Ademaj me tej shton se duhet rishikuar përsëri dhe duhet gjetur variantin më të mirë se si të punohet rreth këtij projektligji.

Kryesuesja –Tha se ligjit i mungon sistemimi, koherenca dhe gjithashtu qartësimi i nocioneve. Znj. Halimi theksoi se nuk ka nevojë që të tërhiqet projektligji por propozon që të jepen vërejtjet në komision dhe të kërkohet nga komisioni që grupi punues i cili ka punuar në këtë projektligj, së bashku me komisionin për legjislacion të punojnë dhe të bëjnë një ri sistemim të këtij ligji me qëllim që të eliminohen të gjitha mangësitë që u ceken më lart, që në fund të bëhet një ligj i zbatueshëm. Në fund ajo propozon që të shkohet me dy grupet punuese ose të kërkohet që ky projektligj të tërhiqet.

Armend Zemaj - Tha se legjislacioni që është hartuar kohëve të fundit jashtë kushteve normale, kur nuk na është lejuar zhvillimi i seancave në mënyrë të rregullt, po shihen pasojat në hartim të legjislacionit. Nuk mendoj që duhet të thirren grupet punuese, sepse nuk e kemi logjikën e hartuesit të këtij projektligji se çka kanë dashur të ketë risi në këtë projektligj, deputeti Zemaj merr shembull komentarin mbi Procedurën Administrative ku thotë se nëse shikohet ky komentari dhe Projektligji në të tri gjuhët ka dallime të mëdha, sidomos në gjuhën angleze ku nuk ka terma të saktë juridik. Deputeti Zemaj theksoi se ne, si komision, nuk duhet të lejojmë që ky projektligj të kalojë në këtë mënyrë dhe gjithashtu tha se duhet t'i kthehet sponsorizuesit ose Komisionit Funksional dhe nëse ata mendojnë se duhet të aprovohet, ne paraqesim rekomandim në seance plenare që ky projektligj nuk duhet të kalojë në lexim të dytë.

Kryesuesja- Në fjalën e saj të sërishme shtoi se asnjë nga anëtarët e komisionit nuk u pajtua që ky ligj të procedohet tutje, por që të mos kthehet mbrapa, kryesuesja propozon të gjendet një mënyrë që të formohen grupe punuese në bashkëpunim me propozuesin në mënyrë që të kemi ligj të mirë, apo t'i kthehet komisionit dhe ata pastaj mund të kërkojnë që ky ligj të adresohet në komisionin për legjislacion, potencoi në fund znj. Halimi.

Anëtarët e Komisionit nuk u pajtuan me propozimin e deputetes, znj. Selviqe Halimi, që të formohet grup i përbashkët punues.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Komisionit Funksional t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Të mos miratohet Projektligji nr. 05/L-031 për Procedurën e përgjithshme administrative;

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL janë të natyrës teknike dhe nuk e ndryshojnë përmbajtjen e Projektligjit.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Të ndryshme

Kryesuesja i informon anëtarët e komisionit se janë plotësuar kushtet sipas rregullores së punës që Projektligji nr. 05/L-049, për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar dhe Projektligjin nr. 05/L-060, për Mjekësinë Ligjore të procedohen për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Komisioni për Integritet Evropian, në afatin e përcaktuar me rregulloren e Kuvendit, nën 57.8 nuk e ka shqyrtuar Raportin me amendamente dhe i njëjti procedohet në Kuvend pa raportin e Komisionit për Integritet Evropian. Komisionet e tjera nuk kanë vërejtje në Projektligjet e theksuara.

Meqë nuk kishte më diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar dhe Projektligjin nr. 05/L-060, për Mjekësinë Ligjore dhe amendamentet e propozuara procedohen për shqyrtim të dytë në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi